VENDIM
Nr. 673, datë 16.10.2019

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (këtu e më poshtë AKAFPK), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional (këtu e më poshtë ministri), me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. AKAFPK-ja ka për mision sigurimin e një sistemi të unifikuar të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), si dhe sigurimin e cilësisë së mësuesve/instruktorëve të arsimit e formimit profesional (AFP), nëpërmjet kualifikimit dhe trajnimit të vazhduar.

4. AKAFPK-ja ushtron veprimtarinë e saj në:

a) krijimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të sistemit të unifikuar të kualifikimeve profesionale;

b) kualifikimin dhe trajnimin e vazhduar të personelit mësimdhënës të arsimit dhe formimit profesional.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AKAFPK-së

AKAFPK-ja ka përgjegjësi:

a) të organizojë punën për të garantuar nivelin e cilësisë së Listës Kombëtare të Kualifikimeve dhe të Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale;

b) të organizojë punën për të garantuar standardet e profesioneve;

c) të organizojë punën për të garantuar nivelin e kualifikimit të personelit mësimdhënës të arsimit dhe formimit profesional;

ç) të organizojë punën për të garantuar zbatimin e standardeve dhe të programeve kombëtare nga institucionet publike ofruese të AFP-së;

d) të vlerësojë cilësinë dhe të akreditojë ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2 - 5 të KSHK-së si dhe qendrat e vlerësimit për zbatimin e procedurave të njohjes të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AKAFPK-së

1. AKAFPK-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. AKAFPK-ja i ushtron funksionet e saj në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për kornizën e kualifikimeve.

3. AKAFPK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, përfaqësuesit e sektorëve ekonomikë etj.;

b) harton dhe rishikon Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të KSHK-së;

c) harton dhe rishikon standardet e profesioneve;

ç) harton dhe rishikon standardet e kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së, në terma të rezultateve të të nxënit, si dhe të standardeve të vlerësimit për kualifikimet profesionale;

d) këshillohet me palë të interesuara për zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e procedurave për përfshirjen e kualifikimeve në KSHK;

dh) propozon ndryshimet në kritere dhe proceduara për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve profesionale, që përfshihen në KSHK;

e) ndjek procedurat për vlefshmërinë e cilësisë së kualifikimeve, pjesë e KSHK-së, në bashkëpunim me komitetet sektoriale;

ë) harton dhe rishikon programet (kurrikulat) kombëtare për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së;

f) harton dhe rishikon programet e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik;

g) monitoron zbatimin e standardeve dhe të programeve (kurrikulave) kombëtare nga institucionet publike ofruese të AFP-së;

gj) përcakton kriteret e vlerësimit dhe të certifikimit të nxënësve e kursantëve në sistemin e AFP-së;

h) harton materialet mësimore mbështetëse për ofruesit e AFP-së;

i) harton programet orientuese të provimeve të niveleve dhe provimit të maturës shtetërore profesionale për çdo kualifikim profesional të niveleve 2-5 të KSHK-së;

j) harton dhe rishikon standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së;

k) akrediton ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së si dhe qendrat e vlerësimit për zbatimin e procedurave të njohjes të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal;

l) harton programet kombëtare, administron dhe monitoron procedurat për kualifikimin dhe atestimin e vazhduar të mësuesve dhe instruktorëve të kulturës profesionale të AFP-së;

ll) mbështet metodologjikisht njësitë e zhvillimit të ofruesve të AFP-së;

m) mbështet ofruesit e AFP-së për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në përputhje me kriteret e akreditimit;

n) harton dhe rishikon standardet dhe kriteret e akreditimit të qendrave për zhvillimin e procedurave të njohjes të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal;

nj) harton dhe zbaton projektet kombëtare e ndërkombëtare për jetësimin e prioriteteve në fushën e AFP-së;

o) mbështet administrativisht organet tripalëshe të përfshira në zhvillimin e AFP-së, në përputhje me mandatin dhe funksionet e institucionit.

4. AKAFPK-ja raporton në mënyrë periodike, të paktën 1 herë në vit dhe sipas rastit, pranë ministrit përgjegjës për AFP-në.

5. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKAFPK-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

6. AKAFPK-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, që e përfaqëson në marrëdhënie me të tretët dhe ka për detyrë të organizojë, të administrojë e të drejtojë veprimtarinë e AKAFPK-së duke zbatuar politika efektive në menaxhimin e burimeve njerëzore e financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Marrëdhëniet e punës të drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të AKAFPK-së rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AKAFPK-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

8. AKAFPK-ja, për realizimin veprimtarive zhvillimore në fushën e AFP-së në përputhje me funksionet e saj, angazhon specialistë të jashtëm, me kontratë shërbimi.

9. Specialistët e jashtëm ndahen në tri kategori:

a) specialistë të kategorisë së ulët, individë që kanë një diplomë të arsimit të mesëm dhe përvojë pune mbi 3 vjet në fushën për të cilën lidhet kontrata;

b) specialistë të kategorisë së mesme, individë që kanë një diplomë të arsimit të lartë ("Bachelor"/niveli 6 i KSHK-së), në fushën për të cilën lidhet kontrata dhe kanë një përvojë pune mbi 5 vjet në fushën përkatëse;

c) specialistë të kategorisë së lartë, individë që kanë një diplomë të ciklit të dytë/dhe ose të tretë të studimeve ("Master i shkencave" ose "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së), sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në fushën për të cilën lidhet kontrata dhe kanë një përvojë pune mbi 10 vjet në fushën përkatëse.

10. Shpërblimi i specialistëve të jashtëm bëhet sipas lidhjes nr. 1 dhe vëllimit të punës për produktet përkatëse, të përcaktuara në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Struktura dhe organika e AKAFPK-së miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

12. AKAFPK-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e AKAFPK-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKAFPK-së, sipas këtij vendimi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve vazhdon funksionimin e saj në përputhje me strukturën dhe organikën aktualisht në fuqi.

2. Për nëpunësit civilë aktualë të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për AFP-në.

4. Vendimi nr. 321, datë 21.4.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Kategoria e specialistëve të jashtëm	**Masa e pagesës**
I mesëm	500 lekë/orë 60-minutëshe
I mesëm	750 lekë/orë 60-minutëshe
I lartë	1050 lekë/orë 60-minutëshe

Lidhja nr. 2

VËLLIMI I KOHËS SË PUNËS SË SPECIALISTËVE QË ANGAZHOHEN NË REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE ZHVILLIMORE NË FUSHËN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Emërtimi i veprimtarisë zhvillimore	**Orë pune**
I. Hartimi i standardeve të çdo kualifikimi profesional, për çdo nivel të KSHK	
a) Për kualifikime të pjesshme (100-800 orë)	72 deri 136
b) Për kualifikime me kohëzgjatje 1-vjeçare	192
b) Për kualifikime me kohëzgjatje 2-vjeçare	256
c) Për kualifikime me kohëzgjatje 3-vjeçare	320
d) Për kualifikime me kohëzgjatje 4-vjeçare	384
II. Hartimi i standardeve të vlerësimit (për një kualifikim)	192 deri 272
III. Hartimi i standardit të profesionit	256
IV. Hartimi i përshkrimit të profesionit/analizës së punës me nivelet përkatëse të kompetencës në Listën Kombëtare të Profesioneve	56 deri 72
V. Hartimi i përshkruesve të detajuar të niveleve në KSHK	168
VI. Hartimi i kurrikulave kombëtare:	
a) Për kualifikime me kohëzgjatje 1-vjeçare	400
b) Për kualifikime me kohëzgjatje 2-vjeçare	480
c) Për kualifikime me kohëzgjatje 3-vjeçare	560
d) Për kualifikime me kohëzgjatje 4-vjeçare	640
VII. Hartimi i programeve të kurseve të unifikuara të formimit profesional publik (për kurset afatshkurtra me kohëzgjatje deri 800 orë mësimore)	
a) Për kurse 100 300 orë mësimore	48 deri 96
b) Për kurse 300 500 orë mësimore	96 deri 144
c) Për kurse 500 800 orë mësimore	144 deri 192
VIII. Akreditimi i ofruesve të AFP-së (sipas numrit të kualifikimeve profesionale të ofruara)	
a) Kur ofrohen 1-3 kualifikime	192 deri 228
b) Kur ofrohen 4-6 kualifikime	240 deri 272
c) Kur ofrohen më shumë se 6 kualifikime	288 deri 352
Vëllimi total i punës për rishikimin e plotësimit të kritereve të vlerësimit për akreditim nga institucioni i vizituar	15% e vëllimit total të punës të grupit të akreditimit
IX. Hartimi i programeve të kualifikimit të mësuesve të AFP-së (për një nivel kualifikimi):	176
X. Hartimi i materialeve mësimore mbështetëse për mësuesit/instruktorët dhe për nxënësit/kursantët e AFP-së	56 orë pune për 20 faqe A4 (2200 karaktere me hapësira)
XI. Hartimi i materialeve strategjike, metodologjike dhe udhëzuese për AFP-në, si dhe i materialeve për trajnimin e mësuesve/instruktorëve	56 orë pune për 20 faqe A4 (2200 karaktere me hapësira)
XII. Hartimi i programit orientues për provimet përfundimtare (për çdo nivel/drejtim/profil)	40

XIII. Hartimi i njësive të testit	4 (për 10 njësi testi)
XIV. Rishikimi (deri në 50%) i dokumenteve që janë në zbatim (referuar pikave I – VII dhe IX –XII)	10%-30% sipas përcaktimit të pikës 12 të këtij vendimi
XV. Konsulenca e jashtme që bën validimin e dokumentacionit (për pikat I – VII dhe VIII –XII):	10% e vëllimit total të punës së grupit hartues
XVI. Moderimi i jashtëm i procesit të hartimit të dokumentacionit (përfshirë dhe formatimin final të materialit), referuar pikave I – XIII):	30% e vëllimit total të punës së grupit hartues
XVII. Konsulta individuale për aspekte të veçanta në procesin e rishikimit të Listës Kombëtare të Profesioneve	8
XVIII. Konsulta individuale aspekte të veçanta në procesin e hartimit/ rishikimit të Listës Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale	8 deri16
XIX. Trajnimet e mësuesve, instruktorëve dhe përfaqësuesve të biznesit (si vlerësues të nxënësve/kursantëve)	12 orë pune për një ditë trajnim (3 seanca x 90 minuta)
XX. Akreditimi i qendrave të njohjes së të nxënit të mëparshëm (joformal dhe informal)	30 % e vëllimit të punës për akreditimin e ofruesve të AFP-së sipas kapitullit VIII, pikat a, b, c